



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN E
MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE

TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:
KUALIFIKIMI PROFESIONAL
“NDËRTIM”

(Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK)

Tiranë, 2024

1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve për Kualifikimin Profesional “Ndërtim” me strukturë 2+1+1, për provimin e detyruar “**Teori profesionale e integruar**” të Maturës Shtetërore Profesionale. Ai synon orientimin e përgatitjes së individëve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të individëve sepse mundëson zhvillimin e testeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e “**Teorisë profesionale të integruar**” bazohet në:

- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “Ndërtim”, Niveli II i KSHK-së, referuar Niveli II në KEK, (klasa 10-të dhe 11-të);
- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “Ndërtim”, Niveli IV i KSHK-së, referuar Niveli IV në KEK (klasa e 13-të).
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MFE nr. 27, datë 12.12.2023 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2024”.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve dhe që janë në themel të formimit teorik profesional të individit.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e individëve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, si dhe analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të “Teorisë profesionale të integruar”, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e individëve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Qëllimi i provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale është vlerësimi i të nxënësve dhe arritjeve si dhe përzgjedhjen e individëve për arsimim të mëtejshëm.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin e detyruar “**Teori profesionale të integruar**” të Maturës Shtetërore Profesionale të Kualifikimit Profesional “Ndërtim”, është e rëndësishme që herë pas here mësimdhënësit të zhvillojnë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për Kualifikimin Profesional “Ndërtim” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë

hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Ky program përmban rreth 30% të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve të kulturës profesionale. Në këtë program janë përfshirë ato lëndë, të cilat përbëjnë bazën kryesore dhe thelbësore për formimin profesional të individëve.

Individët duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “Teorisë profesionale të integruar” në kuadrin e provimit të detyruar “Teori profesionale e integruar”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për Kualifikimin Profesional “Ndërtim“, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtme:

1. Materiale ndërtimi, kl. 10.
2. Teknikë ndërtimi, kl. 10 dhe 11.
3. Konstrukione ndërtimi, kl. 11.
4. Ligjshmëria dhe organizimi në ndërtim, kl. 13.
5. Teknikë ndërtimi me elemente projekti në ndërtesa, kl. 13.

Tabela 1: Lëndët profesionale të përfshira në programin orientues dhe peshat e tyre përkatëse janë si më poshtë, duke konsideruar vëllimin dhe rëndësinë e tyre në formimin profesional të nxënësve.

Nr.	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Materiale ndërtimi	38	15
2	Teknikë ndërtimi	138	53
3	Konstrukione ndërtimi	50	19
4	Ligjshmëria dhe organizimi në ndërtim	16	6
5	Teknikë ndërtimi me elemente projekti në ndërtesa	18	7
	TOTALI	260	100%

Temat sipas lëndëve janë:

a) “Materiale ndërtimi”, kl. 10:

(38 orë)

- Vetitë kryesore të materialeve të ndërtimit. 12 orë
- Materialet prej qeramike dhe teknologjia e prodhimit të tyre. 8 orë
- Materialet lidhëse joorganike dhe teknologjia e prodhimit të tyre. 6 orë

•	Betonet dhe elementët prej betoni të armuar të parapërgatitura.	6 orë
•	Llaçet e ndërtimit.	4 orë
•	Materialet e bojatisjes dhe patinimit	2 orë
b)	“Teknikë ndërtimi”, kl. 10 dhe kl.11:	(138 orë)
•	Bazamentet.	10 orë
•	Themelet.	16 orë
•	Muret.	16 orë
•	Ndërkatet.	10 orë
•	Shkallët.	10 orë
•	Çatitë e vendit.	14 orë
•	Mbulesat e çative.	10 orë
•	Tarracat dhe pjerrësia e tyre	10 orë
•	Punime suvatimi tavanesh dhe muresh të brendshme e të jashtme.	14 orë
•	Punime nivelimi nënshtresash dhe shtrimi dyshemesh.	14 orë
•	Punime veshje muresh të jashtme (fasadash)	14 orë
c)	“Konstruksione ndërtimi”, kl. 11:	(50 orë)
•	Njohuri për ngarkesat dhe koeficientet e mbingarkesës.	4 orë
•	Njohuri për betonin dhe rezistencat e tij.	4 orë
•	Njohuri për armaturën e hekurit dhe përpunimi i saj.	4 orë
•	Konstruimi i pllakave prej betoni të armuar.	8 orë
•	Konstruimi i trarëve prej betoni të armuar.	14 orë
•	Konstruimi i shtyllave dhe mureve prej betoni të armuar.	8 orë
•	Konstruimi i plintave, trarëve të themelit të kryqëzuar dhe pllakës së themelit prej betoni të armuar.	8 orë
d)	“Ligjshmëria dhe organizimi në ndërtim”, kl.13:	(16 orë)
•	Njohuri për ligjshmërinë dhe rregullat në ndërtimin e objekteve.	2 orë
•	Njohuri për sipërmarrjen dhe menaxhimin e biznesit të ndërtimit.	4 orë
•	Njohuri për dokumentacionin teknik të objektit në ndërtim.	4 orë
•	Njohuri për sigurimin e cilësisë së punimeve në ndërtim	4 orë
•	Njohuri për aktin e kolaudimit për shfrytëzimin e objektit të ndërtuar	2 orë
e)	“Teknikë ndërtimi me elemente projekti në ndërtesa”, kl.13:	(18 orë)
•	Njohuri për urbanistikën dhe zonimin urbanistik .	5 orë
•	Njohuri për projektin urbanistik të bllokut të banimit.	5 orë
•	Njohuri për llojet e ndërtesave në zonat urbane.	3 orë
•	Njohuri për funksionin në mjediset e brendshme të ndërtesave të banimit.	5 orë